

**Njoftim i përqendrimit me të cilin Cvajte Pirer Betajligungs GmbH nga Austria do të fitojë kontroll të pavarur mbi LEONI AG nga Gjermania**  
**(lënda nr. 08-69 të datës 19.04.2023)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 19.04.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim që i referohet kontrollit të pavarur nga Cvajte Pirer Betajligungs GmbH me seli të regjistruar Edisonshtrese 1, 4600, Vels Austri, mbi LEONI AG me seli të regjistruar në Marienshtrese 7, 90402, Ninberg, Gjermani, përmes blerjes indirekte të 100% të pjesëve nga një strukturë blerjeje e përbërë nga subjekte mbi të cilat kontroll përfundimtar ka z. Pirer.

Parashtruesi është një shoqëri e themeluar nga z. Shtefan Pirer me qëllim që të zbatohet Transaksioni.

Aktivitetet e biznesit të z. Pirer mbahet nga Pirer Konzerngesellschaft mbH, e cila nga ana tjetër zotëron të gjitha aksionet në Pirer Industri AG, një grup global investimesh aktiv në prodhimin dhe shpërndarjen e motoçikletave, biçikletave elektrike si dhe pjesëve për automjete me dy rrota.

Përmes PIRER Mobiliti AG, PIRER Industri AG është aktive në prodhimin dhe shpërndarjen e motoçikletave, biçikletave elektrike si dhe pjesëve për mjete motorike me dy rrota.

PIRER Mobiliti AG ofron një përzgjedhje të gjerë të markave, duke përfshirë markat e motorçikletave të performancës si KTM, Husqvarna Motorcycles dhe GASGAS. PIRER Mobiliti zhvillon një gamë gjithëpërfshirëse të produkteve të motoçikletave elektronike dhe biçikletave përmes markave Husqvarna E-Bicycles, GASGAS Bicycles, FELT Bicycles dhe R Raymon, prodhon komponentë nën markën WP dhe prodhon dhe shpërndan makina sportive përmes divizionit të saj KTM X-BOW.

Pirer nuk është e regjistruar në Maqedoninë e Veriut, por ka gjeneruar të ardhura në vitin 2022 në Maqedoninë e Veriut përmes shoqërisë së saj të varur.

LEONI AG është një ofruer global i produkteve, zgjidhjeve dhe shërbimeve të menaxhimit të energjisë dhe të dhënave për industrinë e automobilave. Zinxhiri i vlerës varion nga kabllo e standardizuara dhe kabllo dhe të dhënat speciale, te sistemet e instalimeve elektrike shumë komplekse dhe komponentët e lidhur, nga zhvillimi te prodhimi.

Operacionet e biznesit të LEONI AG ndahen në dy divizione, divizioni i zgjidhjeve të telave dhe kabllove dhe ai i sistemeve të telit. RZHK përgjithësisht ndahej në tre grupe biznesi: Zgjidhje kabllore për automobila, produkte dhe shërbime me tela dhe zgjidhje industriale. Çdo grup biznesi përbëhej nga shoqëri të varura të ndryshme. Siç u përmend në f. 4 të këtij Njoftimi, tashmë janë marrë disa masa ristrukturimi, si p.sh shitja e BG IN.

LEONI AG nuk është e regjistruar në Maqedoninë e Veriut, megjithatë, ajo gjeneroi të ardhura në vitin 2022 në Maqedoninë e Veriut përmes shoqërisë së varur të saj të regjistruar.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim të Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

27.04. 2023

Shkup